

SHPLLJE E SINDIKATËS NË SEKTORIN E NDËRTIMIT

PUNËTORËT GREKË DHE EMIGRANTË TË BASHKUAR NË LUFTË KUNDËR SHFRYTËZIMIT, LUFTRAVE DHE EMIGRIMIT

Kolegë, punëtorë në industrinë e ndërtimit, grekë dhe emigrantë

Çdo ditë po shohim se retë e luftës që janë mbledhur në rajonin tonë. Vendi ynë ndodhet në një zonë të rrezikshme, ku përplasen interesat e padronëve vendas dhe të huaj për burimet e energjisë, për tubacionet e gazit, për rrugët e transportit të mallrave etj. Kjo është rruga e tyre për të dalë nga kriza, që të rimëkëmbet ekonomia: Shfrytëzim më të madh për popujt e tyre dhe një rishpërndarje e përgjakshme e kufijve, e tregjeve dhe në të njëjtën kohë duke shfrytëzuar edhe popujt e tjerë. **Lufta e tyre shkatërron atë që lë në këmbë paqja e tyre!**

Ndërsa në kohët e zhvillimit ekonomik ata na shtrydhën për të nxjerrë sa më shumë fitime nga shfrytëzimi jonë, tani që ekonomia e tyre përballet me vështirësi për rimëkëmbje, rritet konkurrenca mes bankierëve të ndryshëm, mes industrialistëve, pronarëve të anijeve, mes padronëve të mëdhenj në ndërtim në Greqi, por edhe mes shteteve të ndryshme. Edhe pse të gjithë së bashku pajtohen me mënyrën se si do ta shtypin klasën punëtore, mes tyre grinden gjer në kulm për ndarjen e tregjeve, se cili do të humbasë dhe kush do të dalë më i fituari nga kriza. Nuk ka krim që nuk do të përpiqet të bëjnë, në qoftë se besojnë se kjo do të përmirësojë pozitën e tyre në konkurrencë, dhe në këtë mënyrë pjesë shumë herë dhe Greqia (p.sh. në Jugosllavi).

Përgjegjësi të madhe ka edhe qeveria e tanishme e SYRIZA-ANEL, si dhe të gjitha qeveritë e mëparshme. Jo vetëm që nuk e mohon pjesëmarrjen e Greqisë në këto plane, por synon që ta bëjë dhe më aktive, të pretendojë edhe kjo pjesë. Shpenzon çdo vit 4 miliardë euro për shpenzime në armatime të NATO-s, në të njëjtën kohë shkurton pagat dhe pensionet, që nuk ka shkolla dhe spitale, që sa herë që bie shi përmytet gjysma e Athinës.

NATO që thër popujt për interesat e imperialistëve, që nuk njeh kufij mes shteteve anëtare të saj, nuk mund të sjellë stabilitet dhe siguri në rajon. As shkeljet e kufirit dhe abuzimin e të drejtave sovraane nga Turqia as refugjatët nuk mund të ndalojë, pasi lufta dhe mjerimi që ajo mbjell janë shkaqet që i lindin të gjitha këto!

Në rast lufte, ndërsa punojmë së bashku në ndërtim bashkë me punëtorë nga shtete të ndryshme, do të na vënë padronët të vritemi njëri me tjetrin, me synim që ata të fitojnë përsëri. **Popujt nuk kanë asgjë për të ndarë mes tyre.** Punëtorët, pavarësisht nga kombësia, raca, feja, kemi të njëjtat probleme, të njëjtat nevoja dhe të njëjtin armik, atë që na vjedh djersën tonë në periudhën e "paqes" dhe atë që kërkon gjakun tonë në periudhën e "luftës".

Punëtorët dhe shtresat e varfra popullore në vendin tonë, por dhe të çdo shteti, nuk kanë asnjë interes për të luftuar në emër të atyre që i shtrydhin, d.m.th të

bankierëve, industrialistëve, pronarëve të anijeve, tregtarëve të mëdhenj. Pra, si në paqe ashtu dhe në luftë, duhet të vihen në qendër të luftës nevojat bashkëkohore-popullore dhe në shënjestrën tonë kundërshtarit e vërtetë, atë që na vret çdo ditë. Luftojmë kundër luftës, por edhe kundër këtij sistemi shfrytëzues. Vetëm kjo luftë mund të na shpëtojë nga vuajtjet që kalojmë çdo ditë dhe nga luftërat në përgjithësi dhe do të na japë mundësinë për të përmbushur nevojat tona. Kjo luftë ja vlen për çdo sakrificë dhe pikërisht nga kjo dridhen nga frika shfrytëzuesit e gjithë botës!

Klasa punëtore dhe populli i vendit tonë, nëpërmjet sindikatave punëtore dhe komiteteve militante kërkojmë:

- Asnjë pjesëmarrje të Greqisë në luftërat dhe ndërhyrjet imperialiste kundër popujve të tjerë të rajonit. Asnjë ushtar grek jashtë kufijve.
- Të mbyllen tani bazat e vdekjes. Të largohet menjëherë NATO nga Deti Egje. Të mos jepet asnjë ndihmë, asnjë strukturë e vendit (porte, aeroporte, etj.) si baza për sulme kundër shteteve të tjera. As toka dhe as ujë për vrasësit e popujve.
- Asnjë ndryshim kufijsh. Popujt të mos e lejojnë që të derdhen gjakun e tyre për interesat e plutokracisë.
- Solidaritet ndaj refugjatëve dhe emigrantëve, ndaj viktimave të luftërave imperialiste dhe të shfrytëzimit.

E vetmja rrugë për të jetuar më mirë, pa shfrytëzim, ne dhe fëmijët tanë është lufta klasore, konfrontimi i përgjithshëm me kapitalin dhe shërbëtorët e tij politik, përmbysja e pushtetit të monopoleve.

Të bëhemi ne zot të jetës sonë dhe të pasurisë që ne prodhojmë!

FTOJMË TË GJITHË KOLEGËT QË TË MARRIN PJESË NË TAKIMIN PËR 1 MAJIN ME TEMË, QËNDRIMI I PUNËTORËVE NË LUFTË

**TË ENJTEN 27 PRILL, ORA 19:00
NE SALLËN E SINDIKATËS SË NDËRTUESVE E ATHINËS
RRUGA VENRANZERU-1, SHESHI KANIGOS, KATI I 2-të**

**FEDERATA E NDËRTUESVE E GREQISË
SINDIKATA E NDËRTUESVE E ATHINËS
SINDIKATA E ELEKTRICISTËVE E ATIKËS JUGORE
SINDIKATA E PUNËTORVE-TEKNIKË TË PËRPUNIMIT TË DRURIT E ATIKËS JUGORE
KOMITETI MILITANT I TEKNIKËVE ME PAGË**